



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

**NJOFTIM**

**Rasti:** Përftimi i kontrollit të aksioneve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD nga shoqëria 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.60 prot., datë 20.01.2022, “Konfirmim i Depozitimit të Dokumenteve”, me të cilën jemi njoftuar mbi transaksionin e kryer ndërmjet shoqërisë 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag dhe aksionareve të shoqërisë Albania Telecom Invest AD.

Referuar dokumentit “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, palët në marrëveshje janë:

**Pala blerëse:** 4iG Nyilvanosan Mukodo Reszvenytarsasag, është një shoqëri aksionare/ publike e kufizuar, me objekt veprimtarie: prodhim kompjutera dhe pajisje periferike, prodhim i makinerive dhe pajisjeve të zyrës (përveç kompjuterëve dhe pajisjeve periferike), montimi i makinerive dhe pajisjeve industriale, organizimi i projektit të ndërtimit të objekteve, përgatitja e sipërfaqes së ndërtimit, shërbimet e tregtisë me shumicë të kompjuterëve, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, tregti me shumicë jo e specializuar, shërbimet e tregtisë me pakicë të kompjuterave, njësive periferike dhe programeve kompjuterike, etj.

**Pala shitëse:**

*Shitësi 1:* ATI Albanian Telecom Invest LTD, është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar e themeluar dhe e organizuar sipas ligjeve të Qipros, e cila është krijuar me qëllim për të krijuar e vetme ose në bashkëpunim me të tjerë në çdo vend të botës biznesin e një shoqërie investimesh, etj.

*Shitësi 2:* Adarna Eood, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.

*Shitësi 3:* Guri Enterprises B.V, e cila është një shoqëri me formë ligjore të krahasueshme me një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Hollandës. Guri Enterprises B.V, është një shoqëri financiare holding.

*Shitësi 4:* River Styxx Capital EAD, është një shoqëri aksionare, e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Bullgarisë.

**Shoqëria Target:** Albania Telecom Invest AD , është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit të Bullgarisë, me objekt aktiviteti: investime dhe aktivitete në fushën e telekomunikacioneve si dhe çdo aktivitet tjetër që nuk ndalohe nga legjislacioni i Republikës së Bullgarisë.

**Filiali:** *One Telecommunications SHA*, është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: ndërtimin, zotërimin, operimin dhe ofrimin e rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM, të ofrojë shërbimin e roamingut ndërkombëtar, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

**Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al).**